

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit N. V, me venbanim në Gj, me mbrojtësin me autorizim av. Rr. L nga Gj, për shkak të veprës penale Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 198 paragrafi 1 të KPRK-s dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 740/2014, të datës 02.05.2014, të cilën e përfaqësonte Prokurori Esat Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 18.01.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri N.V, nga i ati T dhe e ëma A, e lindur M, i lindur më në fshatin P, K. K, tani me vendbanim në Gj, ka të kryer shkollën e mesme, polic në stacionin e policisë në Gj, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa gjykuar dhe nuk udhëhiqet vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

I.

Sepse më datë 01.04.2014 rreth ores., në Gj...në rrugën e Gj... afër hyrjes së tregut të gjelbërt, duke e keqpërdorur detyrën apo autorizimet e tij prej oficerit të policisë në Stacionin Policor në Gj. e ka keqtrajtuar, frikësuar dhe e ka fyer rëndë dinjitetin e të pandehurit të parë Xh. Snga Gj, në atë mënyrë që gjatë shoqërimit të njejtit për në Stacionin Policor në Gj. e ndal automjetin, del prej tij e hap derën e pasme dhe në prezencë edhe të qytetarëve tjerë fillon ta godas me grushta dhe shqelma të njejtin, për shkak se sipas tij ai e kishte fyer rëndë dhe e kishte goditur në kokë gjatë kohës deri sa i njejtin ishte duke e drejtuar automjetin e policisë për në Stacionin Policor.

Me çka ka kryer veprën penale Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 198 paragrafi 1 të KPRK-s.

II.

Sepse më datë 01.04.2014 rreth orës 17.00, i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të cilat kanë rezultuar me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të pandehurit Xh. S.nga Gj, në atë mënyrë që të njejtin e grushton dhe e shqelmon në pjesë të ndryshme të trupit, me këtë rast të njejtin i shkaktonte lëndime të lehta trupore në formë si ato janë përshkruar në raportin e Emergjencës së Spitalit Regjional në Gjilan.

Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 45, 46, 47, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin,

E G J Y K O N

I. Të akuzuarit **N. V**, për veprën penale nga dispozitivi **I** i këtij aktgjykimi i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Në bazë të nenit 47 të KPRK-s, dënimi me 150 ditë burg **ZEVENDSOHET** me **dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) euro**, me pëlqimin e të pandehurit N. V, të cilin dënim do ta

paguaj në afat prej 90 dite pasi që aktgjykimi të bëhet i formës e prerë, nëse nuk e paguan dënimin me gjobë, dënimi me gjobë revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me 150 ditë burg.

III. Për veprën penale nga dispozitivi **II** të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënimi gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari do t'a paguaj në afat prej 60 ditë nga data kur aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

IV. Nëse i pandehuri refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurin mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

V. I pandehuri gjithësej duhet ta paguaj shumën prej 2500 euro.

VI. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në contest civil.

VII. Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Kundër të akuzuarit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njejt i ka kryer veprat penale lëndore të përshkruara më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 18.01.2017, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan Esat Ademi në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.//// në fjalën përfundimtare deklaroi: sa i përket aktakuzës së ngritur nga ana e PSH lidhur me të mbrojturin tim të pandehurin N. V konsideroj se gjatë seancave të mbajtura gjyqësore, dëgjimit të dëshmitarëve, sidomos personat zyrtar B. H, Z. A, B. S. në asnjë mënyrë nuk është argumentuar me asnjë fakt se i mbrojturi im N. V. ta ketë kryer veprën penale si në dispozitivin II keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare nga neni 198 të KPRK-s. Konsideroj edhe një herë se vepra penale si në dispozitivin II nuk është kryer, tani nga të gjitha këto i propozoj kësaj gjykate që ti analizojë të gjitha provat si në shkresat e lëndës dhe të bie aktgjykim lirues.

I akuzuari N. V, në fjalën përfundimtare deklaroi: e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe kërkojë nga gjykata që të më lirojë nga përgjegjësia penale.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike :

se është vërtetuar se i akuzuari N. V, nga Gjilani, i ka kryer veprat penale Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 198 paragrafi 1 të KPRK-s dhe veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-s.

Këtë gjendje faktike, gjykata e konstatoi duke u bazuar në këto prova :

- Dëshmia dhe deklaratat e dëshmitarve Z.A, B. S, R. T, F. N e posaqërisht të dëshmitarit okular X I.
- deklarata e dëshmitarit F.B e dhënë në Prokurori,
- Raporti mjekësor i lëshuar në emër të pandehurve,
- Deklaratat e të pandehurve, të dëmtuarëve dhe dëshmitarëve në Polici dhe Prokurori,
- Raportet dhe shkresat tjera që i janë bashkangjitur kallëzimit penal

Dëshmitari **Z. A,** në shqyrtimin sgjyqësor të datës 22.09.2016 deklaroi, pas arrestimit të dyshuarit nga shtëpia e mallrave jemi nisur me veturë në rrugën njëkahëshe në drejtim të tregut të gjelbër dhe kur u nisëm rrugës i dyshuari menjëherë filloi me ofendime verbale të cilat ofendime kishin filluar te shtëpia e mallrave dhe të njejtat i bënte në vazhdimësi dhe ka filluar që të ofendoj me fjalë, filloi ta kërcnojë se do të ia vrasë familjen N, duke thënë “ai nuk e dinë se kush jam unë”, ja ka sha familjen

dhe gjatë tërë kohës që po e transportonim dhe derisa i bënte këto ofendime tërë kohën bënte gjeste me duar duke sqaruar, unë kam qenë në ulësen e prapme të veturës, N. disa

herë ia ka tërhjek vërejtjen që të mos i bëjë ato gjeste, N. e ka ndaluar veturën dhe e ka hapur derën e pasme të veturës dhe ka tentuar ta kap me duar Xh. pasi që ai nuk ishte i prangosur, Xh. ka bërë rezistencë me duar dhe aty ka ardhur deri te një tollovi verbale me duar dhe në atë rastë gjatë asaj shtyerje në mes veti Napa qëllim e ka goditur Xh. në pjesën e kokës, unë jam zgjatur para Xh.. që ta parandaloj, kam kërkuar edhe nga Xh. por edhe nga N. që të qetësohen, ndërsa B.. ka dalur nga ana e Naimit për ta qetësuar situatën dhe pas kësaj ne e kemi prangosur Xh. Si kam dëgjuar unë N .ka thënë se Xh e ka goditur nga mbrapa derisa ka qenë duke vozitur por unë nuk e kam parë se Xh. e ka goditur N. Derisa i ka bërë gjestet është e mundur që e ka goditur. Këtë unë e kam dëgjuar pasi që është prangosur Xh dhe kemi qenë duke shkuar në drejtim të stacionit, pasi që i njëjti nuk ka pranuar vullnetarisht të prangoset, N. ia ka kapur dorën me forcë dhe ka tentuar ta prangos. Xh nuk e kemi prangosur për shkak se me të ka qenë bashkëshortja e tij shtatzënë dhe një fëmijë i tij dhe nuk kemi dashur ti shqetësojmë, ndërsa me procedurë është dashur fillimisht ta prangosum e tani ta fusim në veturë. Te tregu ku është ndaluar vetura e policisë ka pasur njerëz pasi që aty ka shitore dhe aty është treg dhe një person është ndaluar aty dhe i cili ka thënë në kuptim të asaj “ mos bëni gjëra të tilla këtu “, dhe ai nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimi dhe unë nuk kam parë pasi që ka qenë një kohë shumë e shkurtë dhe mendoj se këtë e ka thënë pasi që e ka parë këto fërkime në mes policit dhe Xh.

Dëshmitari okular **Xh. Inë** shqyrtimin gjyqësor të datës 15.08.2016 deklaroi, atë ditë në kam qenë vet në tregun e gjelbërt për të blerë disa gjëra për shtëpi, duke dal nga tregu unë e pashë një veturë të policisë të ndaluar dhe i kam parë disa njerëz që janë grumbulluar jam ofruar edhe unë që të shiqoj se çka po ndodhë dhe kur jam ofruar polic i cili më duket se është i akuzuari në sallë, pasi që prej asaj kohë më se kam parë më, një person ka qenë mbrapa në veturë ku xhami ishte i hapur dhe polici në fjalë e godiste me grushta në kokë atë personin e ulur prapa në veturë. Aty kanë qenë edhe dy polic një femër dhe një mashkull, policja ka qenë jashtë nga dera e djathtë e parë ndërsa polici tjetër ka qenë brenda në veturë nga ana e djathtë mbrapa. Këta dy polic nuk e kanë sulmuar atë personin por as nuk e kanë ndaluar kolegun e tyre i cili e godiste personin, i ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë në Prokurori ku ka deklaruar “policja që ishte me te u mendojke që ta ndalonte policin në fjalë që të mos sillej në këtë mënyrë ndaj personit që e kishte në veturë” për këtë pjesë të deklaratës nuk më kujtohet, por e di se kam deklaruar “se një person civil e ka ndal policin duke e kap për duar pasi që ky person ishte trupmadhë”, është e vërtetë deklarata ku kam deklaruar “quditem si ka guxuar personi në fjalë ti afrohet policit i cili me këtë rast e kishte humbur kontrollin” dhe mendoj se se polici është dashur ta dijë se është në vend public dhe se aty ka shumë dëshmitar, unë personalisht e kam parë që polici e ka grushtuar atë person 5-6 herë, e më herët nuk e di pasi që aty ka qenë një numër i grumbulluar i njerzëve, unë e kam parë të lënduarin por nuk kam mundur të vrejë ndonji shenjë ose gjak. Unë nuk e di sa ka qenë numri i njerzve të grumbulluar atë ditë, unë kam qenë larg 7-8 metra, unë nuk kam dëgjuar por jam ofruar te vetura dhe aty e kam parë po e ceku edhe një here policin duke e goditur me grushta personin në veturë, polici e ka goditur personin përmes xhamit të hapur, Unë nuk kam dëgjuar dhe nuk kam parë se polici ka qenë i rrahur. Deklaratën e kam dhënë pas 3-4 dite, nuk më kujtohet personi i cili ka qenë në veturë a ka pasë pranga në duar.

I pandehuri **N. V** gjatë mbrojtjes së tij e ka mohur veprën penale duke theksuar se ditën kritike kam qenë në ndërrimin e pas ditës dhe kam qenë në patroll me policin Z. Al, nëpërmes radiolidhjes kam dëgjuar se patrulla në rrugën e Xh kërkon asistencë të njërive tjera policore. Kemi shkuar në vendin e ngjarjes, aty kam vërejtur se ka qenë B. H, H. J. në vendin e ngjarjes kemi qenë 7-8 policë, aty kam vërejtur një person i cili ju ka kundërvu policisë por edhe një zonjë e cila ka qenë shtatzënë. Këta dy personat kanë qenë duke pshtyrë dhe duke i sharë policinë, pas andaj kam kuptuar se ka qenë Xh. S. dhe bashkëshortja e tij. Besniku e ka shoqëruar Xh. te vetura e policisë, ndërsa në këto momente bashkëshortja i ka penguar kolegët e mij duke i kapur për uniforme. Xh. e kemi futur në veturë por nuk e kemi prangosur për shkak se gruaja e tij ka qenë shtatzënë, në veturë unë kam qenë vozitës i veturës, ndërsa B ka qenë e ulur përpara, ndërsa prapa me Xh ka qenë Z. Pasi jemi nisur me veturë unë e kam pyetur Xh. se ku ke qenë ti gjatë luftës pasi që po na fynë neve policëve ai ka thënë se kam qenë në Zvicër dhe mu ka drejtu me fjalët se ti vozitë se kam me ta bërë kështu kështu ty, gras,

fëmive dhe me këto sharje i njëjti e ka arrit qëllimin dhe pas kësaj edhe më ka goditur me dorë në pjesën e prapme të kokës, dhe në hyrje të tregut të gjelbërt unë e kam ndalur veturën, kam dalur dhe e kam hapur derën e pasme në pjesën ku ka qenë Xh dhe kam dashur ta prangosi dhe ai ka rezistuar, unë kam dashur ta kapi për dore dhe ai ka filluar prapë të rezistoj dhe aty ka ardhur deri te konfrontimi fizik mes meje dhe tij derisa nuk kam arritur të ia vendosi prangat, pas kësaj unë e kam prangosur të njëjtin por pasi që kam ndier dhimbje në pjesën e krahut të djathtë dhe në gjoks unë nuk kam mundur të vozisë por ka vozitur Bderi në stacionin e policisë. Kam njohuri se Xh e kanë dërguar për trajtim mjekësor ndërsa unë kam kërkuar trajtim mjekësor por eprori im nuk më ka lejuar por pas 3-4 orëve edhe unë kam shkuar te mjeku. Unë nuk kam komentë lidhur me ate se pse është dhënë raporti mjekësor, ne si polici kemi të drejtë ta prangosur edhe pasi që personin ta fusim në veturë pasi që i njëjti të shfaqet i dhunshëm dhe pozita në të cilën ka qenë Xh ka mundur të prangoset. Unë dhe F B i njohë si figurë, ndërsa atë ditë unë nuk i kam parë në vendin e ngjarjes.

Gjykata pas vlersimit të mbrojtjes së të pandehurit, vlersimit detal të provave të administruara me dëgjimin e dëshmitarve:....., si dhe me leximin e provave materiale: Raportet mjekësore të lëshuara në emër të pandehurve, Deklaratat e të pandehurve, të dëmtuarve dhe dëshmitarve të dhëna në Polici dhe Prokurori, dhe shkresat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv I dhe II të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues deklaratës së dëshmitarit ...në cilësi të dëshmitarit ocular ia fali besimin e plotë sepse deklaratat e të njëjtit është e logjikshme e plotë dhe e drejtë, meq në pika relavante përputhet me deklaratat e dëshmitarve Z..A, B. S, e posaqërishtë me deklaratën e dëshmitarit ocular të dhënë në Prokurori, i cili ka deklaruar se “në hyrje të tregut përballë cigareshitit afër vturës ime është ndalur një vetur e policis dhe ka dalë vozitsi i cili ishte pa flokë dhe e ka hapur derën e pasme të veturës dhe ka filluar ta godas pa ndërprerë me grusht dhe shqelma një person i cili ishte në ulsen e prapme të veturës së policis. Nga këto sjellje të policit jam tmerruar dhe pa menduar fare i jam ofruar atij dhe jam mundur që të njëjtin ta ndali duke e kapur për duarsh policin sepse kur u ofrova e pashë personin të cilin ishte duke e goditur i kishte të lidhura duart dhe ishte në veturë të policis, këtë e kam bërë me qëllim ma të mirë që të ndërpritet skena e dhunës së ushtruar prej policit ndaj qytetarit, pas kësaj kam kërkuar prej polices që ta drejtoj veturën sepse polici në fjalë që ma vonë kam kuptuar se quhej N e kishte humbur kontrollin me që pa ndërprerje i sillte në kokë dhe trup personit të përmedur të cili as që e njoh por nëse e shoh mund ta identifikoj”. Raportet mjekësore të lëshuara në emër të pandehurve, Deklaratat e të pandehurve, të dëmtuarve dhe dëshmitarve që gjenden në shkresa të lëndës si dhe pjesërisht edhe me deklaratën e të pandehurit.

Gjykata e shton besimin se vërtetë i pandehuri gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare e ka keqtrajtuar të pandehurin Xh dhe me këtë raast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore meq edhe një pjesë e mbrojtjes së të pandehurit përputhet me deklaratën e dëshmitarve, i cili ka deklaruar përkitazi me atë se atë ditë në veturë Xh kinse e ka fyer, sharë dhe e ka goditur dhe me këtë rast i njëjti e ka humbur durimin dhe e ka ndal veturë dhe ka dalë prej saj dhe kinse ka dashur ta prangosë pasi që kinse të njëjtin e kanë futureë në veturë pa pranga edhe pse me procedura duhet ta prangosin (ndërsa sipas dëshmitarit ocular F. ai ka qenë prangosur), por pasi që ai ka refuzuar i pandehuri e ka përdorur forcën e lejuar për ta prangosur dhe me këtë rast është lëndue personi dhe ky vetë.

Ky motiv i të pandehurit gjendjen faktike lidhur me këtë qështje penale e bënë më të besushme dhe më të plotë si tezë të vërtetuar nga gjykata përtej dyshimit të bazuar mirë.

Mbrojtjes së të pandehurit gjykata nuk ia fali besimin sepse e njëjta është në kundërshtim me provat të cilave kjo gjykatë ju fali besimin dhe se mbrojtja e të pandehurit është e pa logjikshme, jo e besushme dhe se me këtë mbrojtje i pandehuri ka pasur për qëllim vetëm që gjykatën ta vëj në lajthim, sa për tui shmangur përgjegjesisë penale lidhur me veprën penale lëndore.

Gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të provave që jua fali besimin e plotë, vërtetoi gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit është përmbushur elementi objektiv Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike

nga neni 198 paragrafi 1 të KPRK-s dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-s, nga ana e të pandehurit. Pastaj elementi subjektiv i cili konsiston në

dashjen direkte, meq i pandehuri e ka ndal veturën në treg dhe në prani të njerzve të grumbulluar aty ka filluar ta godas personin në veturë deris sa një person ka ndërhy () për ta ndarë dhe me këtë rast i shkaktuar lëndime të lehta trupor, edhe pse ka qenë i vetëdëshëm për veprimet e ndaluara të tij.

Gjykata nuk ka vertetuar asnjë rrethanë e cila do ta përjashtonte ose esencialisht do ta zvogëlonte përgjegjësinë penale të pandehurit, andaj edhe ka vërtetuar se i njejtë është përgjegjës penalisht për veprat penale lëndore meq ka poseduar aftësinë mendore përkatsisht për gjykim.

Duke pasur parasysh provat të cilave kjo gjykatë ia fali besimin vërtetoi se në veprimet e të pandehurit janë përmbush të gjitha tiparet e figurës së veprës penale Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 198 paragrafi 1 të KPRK-s dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-s, duke e shpallur fajtor dhe denuar të njejtin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-s, pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj të akuzuarit, si rrethana lehtësuese mori parasysh: sjelljen korrekte në gjykatore, se është njeri familjar mbajtës i familjes 4 anëtare, është nxitur edhe nga ana e të pandehurit Xh, më parë nuk ka qenë i gjykuar, kurse si rrethana rënduese, shkalla e përgjegjësisë penale, rrezikshmëria shoqërore, vepra është kryer nga personi zyrtar në vend publik dhe lëndimi i shkaktuar të pandehurit Xh.

Duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura gjykata, është bindur se me një dënim me gjobë prej 500 euro, dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 150 ditë i cili dënim në bazë të nenit 47 zëvendsohet me dënim me gjobë prej 2000 euro, mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP-s, se ky dënim është i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe do ta parandalonte të akuzuarin që të mos kryej vepra penale.

Në kuptim të nenit 368 të KPP-s, palët u njoftuan se kanë të drejtë në ankesë, i cili udhëzim u shënuar në procesverbal.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-s.

Për arsyet e lartcekura u vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 570/2016, Më 18.01.2017

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

